

REPUBLICA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Ministri

5705
Nr. ... Prot.

Tiranë, më *01.08* 2014

U D H Ë Z I M

Nr. *17*, datë *01.08*.2014

PËR

ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË 2014, SESIONI I DYTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26, 27 dhe 50, të Ligjit Nr. 69, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit të Këshillit Ministrave Nr.1013, datë 10.12.2010 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 352, dt. 03.04.2013 "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit Shtetëror të Arsimit"

U D H Ë Z O J:


1. Zhvillimin e Provimeve Kombëtare të arsimit bazë 2014, sesioni i dytë, në datat si më poshtë vijon:

<i>a) Gjuha shqipe</i>	<i>27. 08. 2014</i>
<i>b) Matematika</i>	<i>30. 08. 2014</i>
2. Nxënësit e pakicave kombëtare (greke dhe maqedonase) të zhvillojnë provimin në lëndën "*Gjuhë amtare*", sesioni i dytë, në datën *25.08. 2014*.
3. Për Provimet Kombëtare të arsimit bazë 2014, sesioni i dytë, të ndiqen procedurat e përcaktuara në Rregulloren Nr.2481, datë 09.04.2014 "Për procesin e organizimit dhe zhvillimit të Provimeve Kombëtare të arsimit bazë (Provime të Lirimit) 2014".
4. Provimet Kombëtare të arsimit bazë 2014, sesioni i dytë, të fillojnë në orën 10:00 dhe të

zgjasin 2 orë e 30 minuta.

5. Hartimi i testeve të kryhet sipas Rregullores Nr.2481, datë 09.04.2014 “Për procesin e organizimit dhe zhvillimit të Provimeve Kombëtare të arsimit bazë (Provime të Lirimit) 2014”.
6. Për shkollat e pakicës kombëtare greke, testi për provimin në lëndën “**Gjuhë amtare**”, sesioni i dytë, të përgatitet nga DAR Gjirokastrë. Zyra Arsimore Delvinë dhe Zyra Arsimore Sarandë, tërheqin në DAR Gjirokastrë testin, ditën e provimit.
7. Për shkollat e pakicës kombëtare maqedonase, testi për provimin në lëndën “**Gjuhë amtare**”, sesioni i dytë, të përgatitet nga DAR Korçë dhe tërhiqet ditën e provimit nga drejtori i shkollës, shoqëruar nga përfaqësuesi i DAR-së Korçë.
8. Inspektorati Shtetëror i Arsimit të monitorojë procesin e Provimeve Kombëtare të arsimit bazë 2014, sesioni i dytë.
9. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi: Zëvendësministri i Arsimit dhe Sportit, Sekretari i Përgjithshëm. Drejtorja e Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Provimeve. Inspektorati Shtetëror i Arsimit. Drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “*Fletore Zyrtare*”.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR
